



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:269623

Datë: 27.06.2022

Numri i dokumentit: 03173415

A.nr.193/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditëses A. T. e K., kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të anulimit të vendimit me A.nr.31/2018 të datës 29.11.2017, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 27.06.2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A. T. e K.. me seli në P.

II. ANULOHET vendimi A.nr.31/2018 i datës 29.11.2017 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek i padituri.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të LKA-së, me praninë e palëve ndërgjyqëse të ftuara në mënyrë të rregullt.

Paditësi me padinë e datës 06.02.2018 ka kërkuar anulimin e vendimit A A.nr.31/2018 të datës 29.11.2017 për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Konsideron se ATK asnjëherë nuk ka pranuar asnjë rekomandim që të kërkohet përvoja e punës vetëm pas diplomimit, me rastin e shpalljeve për rekrutim. Konstatimi i të paditurit në lidhje me përvojën e punës pas diplomimit bie ndesh me Opinionin e Avokatit të Popullit i cili në cilësinë e mikut të Gjykatës ka lëshuar Opinionin përkitazi me interpretimin e përvojës së punës në kontekstin e konkurseve për punësim në institucione publike, përmes të cilit konstaton se në asnjë rast dhe për asnjë gradë, nuk përcaktohet se përvoja e punës duhet patjetër të jetë fituar pas diplomimit. I propozon Gjykatës që pas administrimit të hollësishëm të provave dhe dispozitave ligjore në

fuqi, të marr aktgjykim me të cilin aprovohet padia e paditësit si e bazuar dhe anulohet vendimi i të paditurit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i paditësit deklaroi: *“Mbesim në tërësi pranë parashtrimeve të dhëna pranë kësaj gjykate përmes padisë të ushtruar kundre vendimit të të paditurës. Duke qenë se të njëjtit i mungon baza ligjore dhe faktike në të cilën thirret. Siç edhe është parashtruar në padi procesi i rekrutimit dt.13.06.2017, është zhvilluar në bazë të ligjit Ntr. 03L-149 të shërbyesve civil si dhe rregullores numër 02/2010 për rekruti të shërbyesve civil. Vendimi i atakuar me padi nuk përmban adresime konkrete lidhur me pretendimet për kundërligjshmëri të vendimit të KZKA-së, dhe duke qenë kështu i kërkojmë gjykatës që ky vendim i KZKA-së, 01/2018 të mbetet në fuqi ndërsa vendimi të paditurës të anulohet”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare, deklaroi: *“Siq kemi kërkuar përmes padisë kërkojmë nga kjo gjykatë që vendimi i goditur me padi përkatësisht vendimi i të paditurës të anulohet ndërsa vendimi i KZK-as dhe ATK-së, të mbetet në fuqi”.*

E paditura në përgjigjen në padi të datës 17.12.2021 e ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar duke pohuar se Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me këtë procedurë të rekrutimit dhe ka dështuar ti eliminojë shkeljet e bëra nga organi i punësimit. I propozon Gjykatës që nga faktet dhe provat e vërtetuara dhe të vlerësuara, të marr Aktgjykim me të cilin refuzohet padia si e pabazuar në ligj dhe mbetet në fuqi vendimi i Këshillit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i të paditurit deklaroi: *“Mbetemi në tërësi pranë përgjigjes në padi duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e palës paditëse si në padi e po ashtu edhe në seancën e sotme, duke konsideruar që pretendimi i palës në seancë që vendimi i kontestuar nuk ka bazë juridike dhe gjendje faktike është pretendim i pa argumentuar dhe i pa qëndrueshëm për faktin që vendimi është plotësisht i bazuar dhe ka një gjendje faktike dhe juridike në pajtim me ligjin për procedurën e përgjithshme administrative dhe ligjet tjera që rregullojnë çështjen. Sa i përket pretendimit që i gjithë procesi në këtë procedurë të rekrutimit ka qenë i ligjshëm, për mos me u lëshuar në të gjitha çështjet në të cilat është theksuar në vendim kontestues në konsiderojmë se krejt ky proces ka vazhduar me shkelej procedurale të evidentuara edhe në vendim, po ashtu paditësja edhe më herët ka zhvilluar procedura të njëjta të cilat janë anuluar për të njëjtat arsye dhe vendimet e këshillit janë zbatuar, por në këtë rast edhe sepse shkeljet ka qenë qenë të njëjta vendimet nuk janë zbatuar. Për më tepër konsiderojmë se të gjitha pretendimet janë të pa bazuara andaj gjykatës i propozojmë që pas a administrimit të provave kërkesëpadia të refuzohet si e pa bazuara dhe të vërtetohet vendimi i kontestuar”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare, deklaroi: *“Mbesim pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve në seancën e sotme. Propozojmë që pas administrimit të provave kërkesëpadia e paditësit të refuzohet ndërsa vendimi i KPMSHCK-së të vërtetohet”.*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave veç e veç dhe të gjitha provave së bashku dhe atë: vendimi i dt. 14.07.2017, njoftimi i dt. 28.07.2017

Lexohet Raporti final i dt. 11.08.2017, vendimi i KPMSHCK-së, me numër A/02/667/2017 dt. 21.12.2017, vendimi i KZKA-së, të ATK-së, me numër 01/2018 i dt. 10.01.2018, vendimi i paditëses numër 84/2017 dt.31.08.2017, ankesa e dt. 29.08.2017, vendimi i të paditurit me numër A.nr.31.2018 dt. 29.01.2018, kërkesa e dt. 07.05.2019, njoftimi i dt. 11.08.2017, vlerësimi i performancës i dt. 27.07.2017, konkursi i jashtëm i dt. 13.06.2017, njoftimi i dt. 31.07.2017, 01.08.2017, 02.08.2017, 03.08.2017, 04.08.2017, vendimi të paditurit me numër 73/2017 i dt. 15.11.2017, ankesa e dt.23.01.2018, ankesa e dt. 13.10.2017, vendimi i KZKA-së i paditëses numër 84/2017 dt. 31.08.2017 si dhe njoftimi i dt. 11.08.2017.

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditëses lidhur me kërkesëpadinë e saj dhe gjeti se padia është e bazuar.

Gjykata shqyrtoi dhe analizoi me kujdes aktin administrativ të kontestuar dhe për të njëjtin gjeti se arsyetimi është kontradiktor në raport me dispozitivin e vendimit.

Gjykata poashtu konstatoi se i padituri me vendimin e kontestuar, nuk ka trajtuar qartë pretendimet ankimore të palës paditëse, ashtu që arsyetimi i vendimit nuk korospondon me kërkesat specifike të palës paditëse dhe nuk përmban dëshmi të plota e të domosdoshme mbi bazën e së cilave është refuzuar ankesa e paditësit.

Nga vendimi i kontestuar del se i njëjti është i përfshirë në shkelje të nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për shkak se me arsyetimin e dhënë, organi i paditur nuk i ka dhënë përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme në raport me ankesën e palës paditëse.

Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku ndër të tjera thuhet se: *“Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil nuk ka përfshirë në listën e shkurtër kandidatë që i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në konkurs, me arsyetimin se këta kandidatë nuk e kanë dëshmuar përvojën e punës me dokument nga trusti pensional, ndërsa ka përzgjedhë kandidatët që të njëjtën përvojë të punës nuk e kanë pasur të dëshmuar me trust të pensionit”*.

Në lidhje me një arsyetim të tillë të dhënë nga organi i paditur, gjykata konstatoi se i njëjti nuk përmban arsye të sakta dhe të arsyetuara mbi bazën e të cilave do të vihej në një konstatim të tillë. Poashtu organi i paditur nuk ka arritur të jap përgjigje dhe të deklarohet sa i përket asaj se mbi çfarë baze ligjore konsiderohet se kandidatët në këtë pozitë, por edhe në pozitat tjera të shërbimit civil në Republikën e Kosovës, duhet të dëshmojnë përvojën e caktuar të punës pas

diplomimit. Rrjedhimisht, një arsyetim i tillë është shkelje direkte e nenit 48, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Organi i paditur, konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative duhet të shqyrtoj përsëri ankesën e paditësit, të shqyrtoj me saktësi çdo pretendim të paditësit, të ftoj paditësin të dorëzoj të gjitha provat e tij materiale, por para së gjithash, organi i paditur duhet të sqaroj deri në detaje bazën ligjore, përkatësisht dispozitat ligjore mbi të cilat është bazuar vendimi i kontestuar me këtë padi.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata konstatoi se në këtë çështje administrative-juridike është shkelur ligji në dëm të paditëses, andaj organi i paditur do të ketë parasysh theksimet nga kërkesa e paditëses.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veprj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë Aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, u mor duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 29, 38 si dhe nenit 46, paragrafit 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.193/18, datë: 27.06.2022

Gj y q t a r i

Kreshnik Kaçi

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:269623
Datë: 27.06.2022
Numri i dokumentit: 03173415